



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1062/2 prot.

Tiranë më 24.7.2019

Lënda: Dhënie mendimi lidhur me përdorimin e kamerave trupore në kuadër të veprimtarisë së Departamentit të Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve, në OSHEE Sh.a.

OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A

Tiranë

I nderuar Administrator,

Bazuar në kërkesën tuaj për mendim nr.14531 prot, datë 05.07.2019, "*lidhur me përdorimin e kamerave trupore në kuadër të veprimtarisë së Departamentit të Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve, në OSHEE. Sh.a*", dhe në vijim të takimit informues midis përfaqësuesve të institucioneve tona, mbajtur në datën 19/07/2019 ora 11:30 pranë ambienteve tona, Zyra e Komisionerit ka analizuar të gjitha argumentet ligjore të paraqitura, në raport me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Duke qenë se përdorimi i kamerave trupore ka një impakt shumë të madh në privatësi dhe me qëllim garantimin e një përpunimi të ligjshëm në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, është e nevojshme që të plotësohen një nga kriteret ligjore të përpunimit. Vlerësojmë se në këtë rast, ashtu si edhe në raste të tjera kur kontrolluesi ka qenë publik, nisur edhe nga eksperiencia e vendeve të tjera europiane, do të ishte e nevojshme që përpunimi të legjitimohej nëpërmjet parashikimit të një detyrimi ligjor të kontrolluesit ose OSHEE (neni 6/1/ç). Kjo nënkupton nevojën e ndërmarrjes së nismave ligjore, hartimin dhe miratimin e një parashikimi ligjor për këtë proces përpunimi të ri që synohet të kryhet nga ana juaj.

Pas marrjes së masave për legjitimimin e këtij procesi përpunimi, lindin detyrimet e tjera që parashikon ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, për çdo kontrollues publik apo privat.

Në këtë kuadër, duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi dhe me qëllim garantimin e një përpunimi të ligjshëm të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të kamerave trupore, është e nevojshme që nga ana juaj të ndërmerren masat si vijon:

- Të kryhet informimi paraprak i subjekteve të të dhënave personale (punonjësit që mban kamerën dhe klientëve) referuar nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Informimi duhet të jetë i plotë dhe i provueshëm.
Përveç mënyrave të tjera, një mënyrë informimi mund të jetë hartimi dhe publikimi në faqen tuaj zyrtare i "Politikës së privatësisë" e cila ka si synim informimin e subjekteve të të dhënave personale dhe publikut të gjerë për fushën dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave personale (për këtë proces përpunimi), funksionarët që kryejnë përpunimin (jo emrat por funksionin), mënyra e përpunimit (shkurtimisht), të drejtat që gëzojnë subjektet e të dhënave (nenet 12-17 të ligjit) dhe masat teknike organizative për sigurinë e të dhënave (shkurtimisht pasi me gjerësisht i ka rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Të merren masa konkrete për garantimin e sigurisë së të dhënave personale nëpërmjet hartimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale (për çdo fazë të mbledhjes, përpunimit, shkatërrimit) në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Rregullat specifike mbi mënyrën, mjetet e përpunimit, të drejtat e aksesit, afatet e përpunimit dhe fatin e të dhënave personale pas përfundimit të saj dhe masat e nevojshme për sigurinë e të dhënave personale, të parashikohen në "Rregulloren tuaj të brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", që është e detyrueshme për çdo kontrollues. Nuk ka asnjë pengesë nëse hartoni një rregullore të veçantë për këtë proces përpunimi;
- Të nënshkruhen deklaratat e konfidencialitetit nga personeli që do aksesojë të dhënat e mbledhura nga sistemi i kamerave trupore, në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Numri i personave që kanë akses sugjerohet të jetë i kufizuar;
- Personeli juaj që do përdorë këto pajisje në terren por edhe ata që do të kenë akses në sistem duhet të trajnohen mbi rregullat dhe detyrimet në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Të përcaktohet afati i mbajtjes së të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të kamerave, në zbatim të nenit 5/1/d të ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar;
- Përpara fillimit të këtij procesi përpunues, të realizohet njoftimi i përpunimit pranë Zyrës së Komisionerit, sipas nenit 21 të ligjit;

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

